



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 29 qershor 2020  
Nr. ref.:RK 1578/20

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI133/19**

Parashtrues

**Nysret Tafili**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 204/2019, të 25 korrikut 2019**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Nysret Tafili, nga Komuna e Kaçanikut, i përfaqësuar nga Sabri Kryeziu, avokat në Lipjan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 204/2019] e 25 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

### **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar përmes të cilit, sipas pretendimit, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

### **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

### **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 23 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
7. Më 29 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 26 shtator 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu e njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 27 maj 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 14 nëntor 2008, përmes Kontratës [06. nr. 784-25] të nënshkruar në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Kaçanikut ishte vazhduar e drejta për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore, ku për qëllim të ushtrimit të veprimtarisë profesionale të parashtruesit të kërkesës si berber ishte i vendosur edhe një objekt montues. Vazhdimi i kontratës së lartcekur bazohet në Kontratën [03. nr. 313-58/83] të 30 qershorit 1983.

11. Më 1 prill 2009, Komuna e Kaçanikut përmes Vendimit [01. nr. 7311/08] vendosi për rrënimin e objektit montues, i vendosur në pronën e dhënë për shfrytëzim të përkohshëm, ku parashtruesi i kërkesës ushtronte veprimtarinë e tij profesionale. Komuna e Kaçanikut Vendimin e saj të lartcekur e kishte bazuar në ndryshimin e destinimit të lokacionit, në të cilin rast sipas nenit VI të Kontratës së lartcekur [06. nr. 784-25] të 14 nëntorit 2008 përcaktohej se largimi i objektit realizohet pa asnjë kompensim nga ana e Komunës.
12. Më 8 mars 2012, parashtruesi i kërkesës në ish-Gjykatën Komunale në Kaçanik kundër Komunës së Kaçanikut paraqiti padi, përmes të cilës kërkoi: (i) kompensimin e dëmit në emër të fitimit të humbur në shumë prej 9,781 euro, duke filluar nga 12 maji 2009 deri më 31 dhjetor 2012, përfshirë edhe kamatën vjetore prej 3.5 %; (ii) duke filluar nga 1 janari 2013 deri më 30 tetor 2014, kompensimin në vlerë prej 2,163.93 euro; (iii) ndërsa nga 1 nëntori 2014 deri në pagesën definitive, pagesën e kamatës vjetore prej 8% bazuar në dispozitat e Ligjit në fuqi për Marrëdhëniet e Detyrimeve; si dhe (iv) pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore. Në një datë të paspecifikuar, në cilësinë e të paditurës përgjigje në padi kishte parashtruar edhe Komuna e Kaçanikut (në tekstin e mëtejme: e paditura).
13. Më 12 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C. nr. 18/12] padinë e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
14. Gjykata Themelore në Aktgjykimin e saj duke u bazuar në provat materiale, përkatësisht Kontratën [03. nr. 313-58/83] e 30 qershorit 1983 dhe Kontratën [06. nr. 784-25] për vazhdimin e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore, e 14 nëntorit 2008 vërtetoi se lokacioni, respektivisht ngastra kadastrale 650/3 në të cilin ka qenë i vendosur objekti montues i parashtruesit të kërkesës ka qenë pronë shoqërore nën menaxhimin e të paditurës, i cili i është dhënë parashtruesit të kërkesës për shfrytëzim të përkohshëm. Gjykata më tej theksoi, se në bazë të Kontratës [06. nr.784-25] të 14 nëntorit 2008 parashtruesi i kërkesës i ka pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo kontratë, përkatësisht në bazë të nenit VI të Kontratës ishte paraparë se nëse vjen deri tek ndryshimi i destinimit të lokacionit të dhënë në shfrytëzim të përkohshëm atëherë objekti do të largohet pa kurrfarë kompensimi. Bazuar në këtë vlerësim, Gjykata Themelore konstatoi se parashtruesi i kërkesës dëmin e kërkuar përmes padisë së tij nuk e ka pësuar me fajin e të paditurës, përkatësisht Komunës së Kaçanikut.
15. Më 24 dhjetor 2014, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në një datë të paspecifikuar, Komuna e Kaçanikut, në cilësinë e të paditurës kishte parashtruar përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës.
16. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës në lidhje me pretendimin për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht nenit 182, paragrafit 2, pika n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK) theksoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban të meta, që konsistojnë në atë se dispozitivi i tij është i pakuptueshëm, siç është i pakuptueshëm edhe arsyetimi i

- tij. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu specifikoi se si rezultat i asaj se Gjykata Themelore nuk kishte bërë vlerësimin e drejtë të provave materiale, Aktgjykimi përmban kundërthënie në mes të arsytimit të tij dhe provave materiale, në të cilat kjo gjykatë ishte bazuar.
17. Parashtruesi i kërkesës, përfundon duke theksuar se Aktgjykimi i shkallës së parë *“[...] është nxjerrë pa u bazuar fare në të drejtën materiale, që ka rezultuar edhe për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe kontestimit të gabuar dhe jo te plotë të gjendjes faktike”*.
  18. Më 6 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 272/2015] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartcekur [C. nr. 18/12], të 12 dhjetorit 2014 të Gjykatës Themelore.
  19. Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin e saj fillimisht konstatoi se *“[...] qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktvendimi i atakuar nuk është përfshire me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK-së”*.
  20. Në vijim, në lidhje me pretendimet e parashtruesit se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i paqartë dhe nuk përmban arsytimet bazuar në provat e dorëzuara nga ai, Gjykata e Apelit vlerësoi se: *“[...] nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është përfshire me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) të LPK-së dhe nuk përmban të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse aktgjykimi i atakuar nuk përmban mangësi për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur edhe lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë”*. Në vijim, Gjykata e Apelit vërtetoi se *“[...] paditësi këtë dëm nuk e ka pësuar me fajin e të paditurës, sepse me kontratën për qiranë me të paditurën i ka pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo kontratë me 06 nr.784-25 e datës 14.11.2008, e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse, ku vërtetohet se kjo pasuri është pronë e Komunës së Kaçanikut dhe se paditësit i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm”*.
  21. Në fund, Gjykata e Apelit konstatoi se në bazë të nenit VI të Kontratës [06. nr. 784-25] të 14 nëntorit 2008 *“[parashtruesi i kërkesës] paraprakisht e ka pasur të ditur se nëse vjen deri te ndryshimi i destinacionit të lokacionit ku ka qenë i vendosur lokali, atëherë do të bëhet largimi i këtij lokali pa kurrfarë kompensimi”*.
  22. Më 28 maj 2019, kundër aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme. Në kërkesën e tij për revizion, parashtruesi po ashtu kishte dorëzuar Aktvendimin në rastin [Rev. nr. 57/2019] e Gjykatës

Supreme të vendosur më 18 mars 2019, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendoi se është identik me rrethanat faktike dhe juridike me ato të rastit të tij.

23. Në kërkesën e tij për revizion, parashtruesi i kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore, përkatësisht nenit 182, paragrafit 1 në lidhje me nenin 189 të LPK-së specifikoi se arsyetimi i dhënë përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (i) është kundërthënës; (ii) nuk është i bazuar në prova materiale, si dhe (iii) nuk adreson pretendimet e tij, të ngritura në ankesën e tij para kësaj Gjykate.
24. Më 25 korrik 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 204/2019] revizionin e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
25. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme fillimisht vërtetoi vlerësimet dhe konstatimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta, të cilat i referohen vërtetimit të gjendjes faktike.
26. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata Supreme arsyetoi se *“[...] thëniet e [parashtruesit të kërkesës] të cekura në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 pika (n) të LPK-së, ngase, siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, se arsyetimi nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare, gjykata e revizionit ka gjetur se aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë në shkeljet e tillat të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në pajtim me provat e administruara kur gjykata ankimore ka gjetur se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë me nr. 784-25 të 14.11.2008, me të cilën jepet në shfrytëzim toka ndërtimore për ushtrimin e veprimtarisë të [parashtruesit të kërkesës]”*.
27. Në fund, Gjykata Supreme konstatoi se *“[...] nuk qëndrojnë thëniet e revizionit të paditësit se e paditura nuk ka mund të disponojë me paluajtshmërinë e cila është në shfrytëzim të përkohshëm [të parashtruesit të kërkesës] për shkak se e njëjta regjistrohët në regjistrat e paluajtshmërive në emër të Kooperativës Bujqësore, nga arsyeja se me pasuritë e kooperativave bujqësore administron komuna në territorin e se cilës gjendet paluajtshmëria [...]”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon që përmes Aktgjykimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
29. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike thekson se Gjykata Supreme në një rast tjetër, i cili sipas tij ngërthen rrethana faktike dhe juridike identike me ato të rastit të tij përmes Aktvendimit të saj kishte pranuar revizionin e palës. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesi thekson se Gjykata Supreme, duke vendosur ndryshe në dy raste identike ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

30. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet rastit të Gjykatës KI145/18 (parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahim*, Aktgjykim i 19 korrikut 2019) për të cilin rast sipas tij Gjykata në një “kërkesë të ngjashme” si me atë në rastin e tij ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
31. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën ta (i) deklarojë të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 204/2019] e 25 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme; dhe (iv) rastin ta kthejë në rivendosje.

### **Dispozitat relevante kushtetuese**

#### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

##### **Neni 31**

##### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

(...)

#### **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut**

##### **Neni 6**

##### **(E drejta për një proces të rregullt)**

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

32. Gjykata së pari, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. 204/2019] e 25 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
36. Gjykata vëren, se parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Aktgjykimi i kontestuar ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
37. Në adresimin e këtij pretendimi, Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

38. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që në bazë të Kontratës [06. nr. 784-25] të 14 nëntorit 2008 të lidhur në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Kaçanikut ishte vazhduar e drejta për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore nga ana e parashtruesit të kërkesës, ku për qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale ishte i vendosur një objekt montues. Më 1 prill 2009, Komuna e Kaçanikut përmes Vendimit [01. nr. 7311/08] vendosi që të rrënohej objekti i lartcekur montues, i vendosur në pronën e dhënë për shfrytëzim të përkohshëm dhe i shfrytëzuar nga parashtruesi i kërkesës. Pas rrënimit të objektit, parashtruesi i kërkesës në ish-Gjykatën Komunale të Kaçanikut në emër të fitimit të humbur, kishte parashtruar padi për kompensim nga Komuna e Kaçanikut. Gjykata Themelore padinë e tij për kompensim e kishte refuzuar si të pabazuar. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit, si rezultat i ankesës së tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke e vërtetuar arsyetimin e Gjykatës Themelore ankesën e tij po ashtu e kishte refuzuar si të pabazuar. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar arsyetimin e dhënë përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, i cili bazohej në Kontratën [06. nr. 784-25] e 14 nëntorit 2008, të nënshkruar në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Komunës së Kaçanikut, në cilësinë e të paditurës. Gjykata e Apelit po ashtu konstatoi se parashtruesi i kërkesës përmes kësaj Kontrate i ka pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo kontratë, përkatësisht në bazë të nenit VI të Kontratës së lartcekur, ku ishte paraparë se nëse vjen deri tek ndryshimi i destinimit të lokacionit të dhënë në shfrytëzim të përkohshëm atëherë objekti do të largohet pa kurrfarë kompensimi. Si rezultat i kërkesës për revizion kundër dy aktgjykimeve të lartcekura të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 204/2019] të 25 korrikut 2019 duke konstatuar se këto dy aktgjykime nuk ishin të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se gjykatat e ulëta drejtë kishin zbatuar të drejtën materiale, revizionin e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar.
40. Rrjedhimisht, në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës, pretendon se Gjykata Supreme duke nxjerrë dy vendime të ndryshme në rrethana identike si në aspektin faktik dhe atë juridik ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në kontekst të këtij pretendimi, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në substancë pretendon cenim të parimit të sigurisë juridike si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme.



41. Prandaj, në adresimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i referohet parimeve të përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës të vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, në pajtim me atë të GJEDNJ-së në kontekst të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

*(i) Parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës*

42. Gjykata fillimisht thekson se parimet dhe kriteret e vendosura nga GJEDNJ, kjo Gjykatë gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj gjyqësore. (Shih rastet e Gjykatës KI87/18, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019 dhe KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 6 janarit, ku Gjykata, ndër të tjera, konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së).

43. Në dritën e zhvillimit të parimeve të përgjithshme përkitazi me mungesën e konsistencës të vendosura përmes praktikës gjyqësore, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata. ((Shih rastin e GJEDNJ-së *Brumărescu kundër Rumanisë* [DHM], kërkesa nr. 28342/95, paragrafi 61; rastin *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, dhe rastin *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56).

44. Sipas GJEDNJ-së “*prezenca e vendimeve kundërthënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë situata të pasigurisë juridike, e cila do ta ulte besimin e publikut në sistemin gjyqësor*”. (Shih rastin *Paduraru kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 63252/00, paragrafi 98; *Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë*, kërkesat nr. 44698/06, paragrafi 56, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009; dhe rasti *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, të cituar më lart, paragrafi 38*). GJEDNJ, megjithatë, ka specifikuar se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. (Shih rastin *Unédic kundër Francës*, kërkesa nr. 20153/04, paragrafi 74, 18 dhjetor 2008, shih rastin e cituar më lart *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e cituar më lart të Gjykatës KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 65, si dhe rastin KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2018, paragrafi 33).

45. Po ashtu, mundësia e vendimeve kundërthënëse është një tipar i pandarë i çdo sistemi gjyqësor i bazuar mbi rrjetin e gjykatave Themelore dhe të Apelit, me autorizime në kuadër të juridiksionit të tyre territorial, dhe një shmangie mund të ndodhë edhe brenda të njëjtës gjykatë, e cila shmangie, nuk mund të konsiderohet e kundërt në vetvete. (Shih rastin *Santos Pinto kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 390005/04, paragrafi 41, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41,

shih po ashtu rastin e Gjykatës KI87/17, parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, të cituar më lart, paragrafi 66).

46. Në vijim, GJEDNJ ka vendosur tri kritere themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime “*të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Iordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar më lart, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues “*IF Skadiforsikring*”, paragrafi 67, të cituar më lart, KI35/18 parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, të cituar më lart, paragrafi 70, KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020).
47. Gjykata vëren se GJEDNJ gjatë zhvillimit të konceptit të “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” gjithashtu mori parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 135).
48. Gjykata në këtë drejtim gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42 - 43).
49. Kjo e fundit ndërlihet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe me çfarë efekti. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, në këtë kontekst, *Tudor Tudor kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 4 marsit 2009, paragrafët 30-32; dhe *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 2 shkurtit 2010, paragrafët 37-38; dhe *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 54).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve dhe kritereve në rrethanat e rastit konkret

50. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave Gjykata dhe GJEDNJ trajton

çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.

51. Fillimisht, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *IF Skadeforsikring* dhe KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, të cituara më lart).
52. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, duhet t’ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76).
53. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në kontekst të pretendimit të tij për cenim të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, ka dorëzuar në Gjykatë Aktvendimin [Rev. nr. 57/2019] e 18 marsit 2019 të Gjykatës Supreme, për të cilin pretendon se rasti i tij ngërthen rrethana të njëjta faktike dhe juridike me ato të rastit të vendosur përmes Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 204/2019] të 25 korrikut 2019 të Gjykatës Supreme. Përveç Aktvendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës po ashtu ka dorëzuar të gjitha parashtruesat dhe vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta përkitazi me këtë rast të vendosur nga Gjykata Supreme [Rev. nr. 57/2019].
54. Në rastin [Rev. nr. 57/2019], të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se ky rast i referohet një paditësi nga Komuna e Kaçanikut, të cilit po ashtu pas rrënimit të lokalit montues në lokacionin e dhënë për shfrytëzim nga autoritetet e Komunës së Kaçanikut, në ish-Gjykatën Komunale të Kaçanikut në emër të fitimit të humbur, kishte parashtruar padi për kompensim. Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik padinë e tij për kompensim e kishte refuzuar si të pabazuar. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit, si rezultat i ankesës së tij kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, duke e vërtetuar arsyetimin e Gjykatës Themelore ankesën e tij e kishte refuzuar si të pabazuar. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit i referohet Kontratës së nënshkruar në mes të paditësit dhe të paditurës në vitin 2003, përmes së cilës paditësit toka shoqërore, e cila ishte nën menaxhimin e Komunës së Kaçanikut i ishte dhënë në shfrytëzim për kohë të caktuar. Gjykata e Apelit po ashtu konstatoi se paditësi përmes Kontratës së vitit 2003 i ka pranuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kjo kontratë, përkatësisht në bazë të nenit V të kësaj Kontrate ishte paraparë se nëse vjen deri

tek ndryshimi i destinimit të lokacionit të dhënë në shfrytëzim të përkohshëm atëherë objekti do të largohet pa kurrfarë kompensimi. Megjithatë, ndryshe nga rasti i parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 57/2019] të 18 marsit 2019 revizionin e paditësit, të parashtruar kundër dy vendimeve të shkallëve më të ulëta e kishte pranuar si të bazuar, dhe rrjedhimisht kishte vendosur që lëndën ta kthejë në rigjykim në shkallë të parë. Gjykata Supreme konstatoi se e pranon si të bazuar pretendimin e paditësit të ngritur përmes revizionit të tij se vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta janë marrë *“me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, për të cilën arsye është dashur që të njëjtat të prishen”*. Sipas Gjykatës Supreme *“Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ekzistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i paqartë dhe nga i njëjti nuk mund të kuptohet se çka ka qenë kërkesëpadi e paditësit dhe çka është refuzuar. Neni 143 par. 1 i LPK -së ka paraparë se me aktgjykim gjykata vendosë mbi kërkesën që ka të bëjë me çështje kryesore dhe me kërkesat aksesore, ndërsa nga aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të kuptohen kërkesat e paditësit, andaj në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet që kërkesën e paditësit ta përfshijë në dispozitivin e aktgjykimit, në mënyrë që të eliminohen shkeljet thelbësore të dispozitave ligjore të theksuar më lart”*.

55. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij i referohet rastit të Gjykatës KI145/18 (parashtrues *Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahimimi*, Aktgjykim i 19 korrikut 2019). Në kontekst të këtij rasti, parashtruesi pohon se Gjykata në rast të ngjashëm si të rastit të tij ka konstatuar shkelje. Në rastin KI145/18 të Gjykatës, parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar se gjykatat e rregullta, duke mos ua njohur të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë kontestuese kishin bërë shkelje të barazisë para ligjit, si dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas tyre, nga e njëjta ish-Gjykatë Komunale në Prishtinë dhe bazuar në kërkesëpadi të njëjtë, iu ishte njohur e drejta mbi pronësinë disa familjeve tjera në të njëjtën Komunë. Në mbështetje të pretendimit të tyre, parashtruesit, kërkesës ia kishin bashkëngjitur tre aktgjykime të ish-Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 164/2003, të 25 shkurtit 2003, C. nr. 146/2009, të 12 nëntorit 2007 dhe C. nr. 98/2010, të 21 janarit 2014. Gjykata në këtë rast konsideroi se Gjykata e Apelit nuk e kishte adresuar fare pretendimin e parashtruesve, të cilët kërkuan që rasti i tyre të trajtohej ngjashëm, me rastet e tjera ku familjet e tjera, si refugjatë të ardhur nga Republika e Shqipërisë, në vitet e 60-ta, kishin fituar të drejtën e pronësisë mbi pronat kontestuese me posedim faktik me anë të parashkrimit fitues. Pas vlerësimit të procedurave në tërësi, dhe posaçërisht nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstatoi se mosadresimi i pretendimit të parashtruesve të kërkesës përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje nenin 6.1 të KEDNJ-së si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit.
56. Megjithatë, bazuar në pretendimet e ngritura nga parashtruesit në rastin KI145/18 dhe vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se ky rast nuk ngërthen rrethana të ngjashme faktike dhe juridike me rastin e parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, duke marrë parasysh edhe faktin që Gjykata nuk kishte konstatuar shkelje të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme ashtu siç pretendohet në substancë nga

parashtruesi i kërkesës por kishte konstatuar shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë si rezultat i mosarsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

57. Gjykata duke iu rikthyer pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme në dy raste identike ka vendosur ndryshe, Gjykata rikujton se në rastet KI87/18 dhe KI35/18, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastin KI87/18 në vlerësimin e 3 (tre) rasteve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare, dhe në rastin KI35/18 në vlerësimin e 9 (nëntë) rasteve të Gjykatës Supreme të nxjerra në një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare dhe pasi kishte konstatuar se (i) kishte “*dallime të thella dhe afatgjata*”; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; por se (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur (shih rastet e Gjykatës KI87/18, cituar më lart, paragrafi 79 dhe paragrafët 81 deri 85, dhe rastin KI35/18, cituar më lart, paragrafi 70 dhe paragrafët 110-111).
58. Përderisa, Gjykata në rastet e saj KI29/17, KI42/17, KI35/18 dhe KI107/19 kishte vlerësuar, se nuk mund të konstatohen “*dallime të thella dhe afatgjata*”, në krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse. Në këtë rast, në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit i referohen vetëm një vendimi, i cili përmban konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi, i nxjerrë në rastin e parashtruesve, Gjykata nuk kishte konstatuar se ishte cenuar parimi i sigurisë juridike. (Shih rastet e Gjykatës: K29/17, i cituar më lart, paragrafi 53, KI42/17, i cituar më lart, paragrafi 44, KI35/18, i cituar më lart, paragrafët 104 dhe 114, dhe KI107/19, i cituar më lart, paragrafi 75).
59. Njëjtë, në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Gjykatë vetëm 1 (një) vendim, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 57/2019] të 18 marsit 2019 të Gjykatës Supreme, për të cilin rast përmes dorëzimit të të gjitha parashtrësve në lidhje me këtë rast ka dëshmuar lidhshmërinë faktike dhe juridike me atë të rastit të tij. Megjithatë, duke iu referuar këtij rasti të referuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të saj [Rev. nr. 57/2019] të 18 marsit 2019 kishte konstatuar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, si rezultat i mospërfshirjes së kërkesës së paditësit në dispozitivin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore, dhe për pasojë lëndën e kishte kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore me kërkesën që të adresohet shkelja e konstatuar nga Gjykata Supreme.
60. Ndërsa në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj [Rev. nr. 205/19] fillimisht kishte vërtetuar se “[...] gjykata e shkallës së dytë mbi bazën e vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, kur ka gjetur se kërkesëpadia e [parashtruesit të kërkesës] është e pabazuar”, dhe në vijim kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se “[...] aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 pika (n) të LPK-së, ngase, siç theksohet dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, se arsyetimi nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare, gjykata e revizionit ka gjetur se aktgjykimi i goditur nuk është

*përfshirë në shkeljet e tilla të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në pajtim me provat e administruara kur gjykata ankimore ka gjetur se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë me nr. 784-25 të 14.11.2008, me të cilën jepet në shfrytëzim toka ndërtimore për ushtrimin e veprimtarisë të [parashtruesit të kërkesës]*”.

61. Bazuar në atë si më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në rastin e parashtruesit të kërkesës kishte konstatuar se aktgjykimet e Gjykatës Themelore nuk ishin të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, duke arsyetuar se dispozitivi dhe arsyetimi i dhënë nga këto Gjykata është i bazuar në provat materiale, mbi të cilat këto Gjykata e kanë bazuar vlerësimin dhe arsyetimin e tyre.
62. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se interpretimi i Gjykatës Supreme, sa i përket fakteve të paraqitura për vlerësim nga parashtruesi i kërkesës, nuk mund të thuhet se ishte arbitrар, i paarsyeshëm apo të ketë mundur të ndikojë në gjykim të drejtë, por ishte thjesht çështje e interpretimit dhe zbatimit të ligjit. (Shih në mënyrë analoge, rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 57).
63. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të një rasti të vetëm, dhe që i referohet rrethanave faktike dhe juridike të ngjashme si ato në rastin e parashtruesit, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës t'i paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme.
64. Andaj, në dritën e praktikës së vet gjyqësore , Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i “*dallimeve të thella dhe të vazhdueshme*” në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktvendim të Gjykatës Supreme, të nxjerrë 4 (katër) muaj më herët. (Shih në mënyrë analoge rastin KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, të cituar më lart, paragrafi 53)
65. Prandaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Gjykata Supreme ka vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të Gjykatës Supreme. (Shih rastin KI29/17, të cituar më lart, paragrafi 58).
66. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të nenit 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 27 maj 2020, njëzëri:

### VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Arta Rama-Hajrizi